

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) është institucion mikrofinanciar i cili me qëllim të instalimit të rrjetit të TI-së, i fton kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për:

## **FTESE PËR PARAQITJEN E OFERTAVE PËR INSTALIMIN E RRJETIT TË TI-SË NË ZYRAT E KRK-SË PËR VITIN 2021**

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK), me qëllim të instalimit të rrjetit të TI-së në zyrat e saj fton kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertat e tyre **për periudhën një vjeçare me mundësi ripërtrirje**, në zyret e saj në Prishtinë, Lipjan, Ferizaj, Kacanik, Viti, Gjiilan, Suharekë, Malisheve, Prizren, Rahovec, Deçan, Gjakovë, Pejë, Istog, Kline, Vushtrri, Mitrovicë, Podujevë, Drenas, Shtime, Skenderaj, Dragash, Kamenicë, Obiliq dhe Fushë Kosovë, për shërbimet si në vijim:

### **1. Furnizimi dhe instalimi i rrjetës pasive (rrjeta LAN dhe rrjeta e rrymës):**

- Kanale plastike që montohen në muri / dysHEME, me dimensione të ndryshme, varësisht prej nevojës,
- Rack cabinet minimum 6U deri në 42U,
- Patch panel min. 24 porte,
- Patch kablla Cat 5e,
- Priza OG rrjetë 2 porte
- UTP kabllo Cat 5e,
- Konektor, jack module,
- Priza rryme,
- Kabllo rryme,
- Kabllo vazhduese,
- Mbështjellës i kabllove (spirale),
- Material tjetër i imtë.

-Instalimi i rrjetit duhet të bëhet nëpër kanale plastike të fiksuara në mur apo dysHEME,  
-Kabllo të rrjetës duhet të jenë të organizuara në rack cabinet në patchpanel, të identifikuara me numër dhe të jenë të sinkronizuara priz – patchpanel.

### **2. Furnizimi, instalimi, konfigurimi, montimi i kamerave dhe zhvendosja e kamerave (analoge dhe IP)**

- DVR / NVR, minimum 4 kanale,
- Kamera –karakteristikat minimale: analoge 1000TVL HD; IP min. 2 MP HD,
- Hard disku me kapacitet minimal 4TB,
- Adapter 240V,
- Kabllo koaksiale,
- Konektor, jack për kamera,
- Zhvendosja e kamerave,
- Material tjetër i imtë.

-Çmimi i paisjes duhet të specifikohet sipas llojit në mënyrë që në varësi të numrit të kamerave të nevojshme të mund të përcaktohet kostoja totale.

Çmimet e ofertuara duhet të jenë me TVSH.

Zgjedhja e ofertës më të volitshme do të bëhet duke u bazuar në kualitetin, çmimin e ofruar.

Afati për paraqitjen e ofertave është nga data **11.12.2020** deri me datën **18.12.2020** në adresën e më poshtme: **Kreditimi Rural i Kosovës LLC / Rr. Behije Dashi, Nr.20 / 10000 Prishtinë** apo përmes email adresës **krk\_imf@krk-ks.com**.